



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.33/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Bujar Muzaqi dhe Violeta Husaj Rugova, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Valmir Rama nga subjekti politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), parashtruar kundër Vendimit Nr.01/2348/2025, të datës 06.09.2025, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me shpërndarjen e komisionarëve në këshillat e vendvotimeve në komunën e Istogut, për zgjedhjet lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.09.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa ZL.Anr.33/2025, e datës 11.09.2025, e parashtruar nga Valmir Rama nga subjekti politik, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), kundër Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Nr.01/2348/2025, të datës 06.09.2025, lidhur me shpërndarjen e komisionarëve në këshillat e vendvotimeve në komunën e Istogut, për zgjedhjet lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 11.09.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga Valmir Rama nga subjekti politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), e dorëzuar përmes postës së Kosovës me datën 08.09.2025, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me shpërndarjen e komisionerëve në Këshillat e vendvotimeve në komunën e Istogut, për Zgjedhjet Lokale, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025. Parashtruesi i ankesës thekson se në zgjedhjet qendrore, IRDK ka dalë partia më e madhe e komunitetit egjiptian dhe menjëherë pas partive të mëdha tradicionale ka marrë numrin më të madh të votave, duke dëshmuar përfaqësimin real politik dhe legjitimitetin elektoral. Në Komunën e Istogut, komuniteti egjiptian përbën pjesën më të madhe të popullsisë pakicë dhe IRDK është subjekti kryesor politik i këtij komuniteti. Parashtruesi i ankesës thekson se nga aspekti i përfaqësimit komunal është e vërtetë që Boshnjacka Stranka ka përfaqësim në Kuvendin Komunal të Istogut, dhe nisur vetëm nga ky parim, asaj do t'i takonin më shumë komisionerë, mirëpo, në të gjitha rrethanat tjera të rëndësishme si në numrin e votave të fituara në zgjedhjet qendrore dhe në përqindjen e popullsisë së komuniteteve në Istog është IRDK që ka peshën më të madhe zgjedhore dhe për këtë arsye duhet të ketë numrin më të lartë të komisionarëve. Parashtruesi i ankesës thekson se vendimi i KQZ-së nuk ka respektuar parimin e përfaqësimit proporcional dhe barazinë e subjekteve politike, duke lënë IRDK-në me më pak komisionerë sesa i takon, në kundërshtim me nenin 63, 64 dhe 76 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe me Kushtetutën e Kosovës që garanton përfaqësimin e drejtë të komuniteteve, dhe duke qenë se

IRDK është forca kryesore e komunitetit egjiptian, mosdhënia e numrit të duhur të komisionarëve e dëmton drejtpërdrejt këtë komunitet, duke i kufizuar të drejtën për mbrojtjen e votës dhe pjesëmarrjen e drejtë në administrimin e procesit zgjedhor. Andaj parashtuesi i ankesës kërkon që PZAP që të pranojë këtë ankesë si të bazuar, të konstatojë se vendimi i KQZ-së për shpërndarjen e komisionarëve në Komunën e Istogut është në kundërshtim me parimin e përfaqësimit proporcional, të urdhërojë KQZ-në të rishqyrtojë shpërndarjen e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve në Komunën e Istogut, dhe të garantojë rritjen e numrit të komisionarëve për IRDK-në, duke përcaktuar që IRDK në Istog të ketë minimalisht 22 komisionarë, në përputhje me peshën reale zgjedhore të partisë si në nivel qendror ashtu edhe lokal.

Në përgjigje në ankesë KQZ-ja thekson se bazuar në Ligji nr. 08/1-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka emëruar "Përbërjen e Këshillit të Vendvotimit (KVV). Kriteret të cilat janë marrë në përcaktimin e përbërjes së këtij trupi menaxhues zgjedhor është e bazuar në Rregulloren Zgjedhore nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve nën 3 si kriter parësor: Subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale kanë të drejtë të përfaqësohen me nga një anëtar në KVV, Kandidati i pavarur i zgjedhur Kryetar Komune në zgjedhjet e fundit, në rast se garon sërish, ka të drejtë të përfaqësohet me një anëtar në KVV, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), sipas nevojës, mund ta rrisë ose ta zvogëlojë numrin e anëtarëve të KVV-së deri në dy (2) anëtarë në KVV reflekton strukturën e anëtarëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ). Edhe në rastin kur kjo është realizuar KQZ ka vazhduar duke marrë për bazë kriteret tjera: KQZ, në bazë të formulës përkatëse, përfshin edhe subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunes, duke u bazuar në përqindjen e votave të fituara, nëse nuk arrihet të plotësohet numri prej pesë (5) anëtarësh në KVV, KQZ mund të kërkojë nominime plotësuese nga subjektet politike të certifikuara në zgjedhjet dhe planifikohen të mbahen (12 Tetori). KKZ ka të drejtë t'i rekomandojë KQZ-së për nominimin e personave me përvojë në proceset zgjedhore, në rast se numri i anëtarëve të KVV-së nuk plotësohet. Me qëllim të rritjes së efikasitetit operacional dhe garantimit të një procesi zgjedhor të rregullt dhe të besueshëm përbërja e një Këshilli të Vendvotimit (KVV) bazohet në strukturën standarde dhe orientuese prej (5) anëtarëve, si në vijim: Kryesuesi i KVV-së, Udhëheq dhe mbikëqyr të gjitha aktivitetet në vendvotim; Kontrolluesi i rreshtit - Mban rreshtin e votuesve dhe vendos sipërmatjet në matrikulues në gishtin e votuesit, zyrtari i identifikimit - përgjegjës për verifikimin e identitetit të votuesve, zyrtari i të dhënave statistikore - regjistron të dhënat lidhur me pjesëmarrjen dhe raportimet teknike, dhënësi i fletëvotimit - shpërndan fletëvotimet. Me përjashtim të Komunes së Prizrenit, Mitrovicës së Veriut dhe Graçanicës, të cilat për shkak të numrit të madh të komuniteteve KQZ ka paraparë nga gjashtë (6) anëtarë në Këshillat e Vendvotimit, në komunat Partesh dhe Ranillug, për shkak të numrit të kufizuar të subjekteve politike të certifikuara për zgjedhjet lokale, vendet e mbetura vakante në Këshillat e Vendvotimit është paraparë të plotësohen nga zyrtarët e administratës së komunave përkatëse. Duke marrë për bazë këto elemente katër (4) subjektet politike parlamentare që kanë kaluar pragun zgjedhor ju takon përfshirja në të gjitha KVV-të. Subjektet Politike, nismat, kandidatët e pavarur që nuk kanë kaluar pragun zgjedhor për Kuvendin e Republikës së Kosovës përfaqësohen në KVV duke marrë parasysh përqindjen e popullsisë në atë komunë dhe rezultatet e fundit në zgjedhjet lokale. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar dy subjekte politike, të cilat prezantohen si përfaqësuese të komunitetit Egjiptian në Kosovë: Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) dhe Partia Liberale Egjiptiane (PLE). Këto dy subjekte janë përfaqësuar me gjithsej 110 anëtarë në Këshillat e Vendvotimeve (KË), në pesë njësi të vetëqeverisjes lokale në Republikën

e Kosovës: Gjakovë, Pejë, Istog, Fushë Kosovë dhe Klinë. Partia Liberale Egjiptiane (PLE) është e përfaqësuar si subjekt i vetëm me 59 anëtarë në KVV, të shpërndarë në këto komuna; Gjakovë: 4 KVV të rregullt dhe 1 rezervë, Klinë: 20 KVV të rregullt dhe 1 rezervë, Fushë Kosovë: 14 KVV të rregullt dhe 1 rezervë, Pejë: 16 KVV të rregullt dhe 2 rezervë.

Në përgjigjen e KQZ-së theksohet se Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës (IRDK) është përfaqësuar si subjekt i vetëm me 51 anëtarë në KVV, të shpërndarë si vijon: Gjakovë: 15 KVV të rregullt dhe 2 rezervë, Istog: 12 KVV të rregullt dhe 1 rezervë, Pejë: 19 KVV të rregullta dhe 2 rezervë. Në total, të dyja partitë kanë mbuluar 110 pozita në Këshillat e Vendvotimeve në komunat ku komuniteti Egjiptian ka prezencë të theksuar. Kjo përbërje reflekton praktikën më të mirë për menaxhimin e një vendvotimi që siguron ndarje të qartë të përgjegjësisë, transparencë dhe rrjedhë të qetë të procesit zgjedhor. Prandaj bazuar në nenin 3 par. 1 të Rregullores Zgjedhore nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve, Përfaqësimi në KVV "KQZ fton subjektet politike të certifikuar të cilat kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale që të nominojnë nga 1 anëtar të KVV-ve". Gjithashtu, KQZ ka vendosur edhe për përfaqësimin në KVV, duke u mbështetur në përkufizimet e nenit 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimeve parashihet që: "KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV, për të gjitha komunitetet, duke u bazuar në: 2.1. Numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune; 2.2. numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet, në nivel vendi dhe në nivel komunal".

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi dhe përgjigjes në ankesë vëren se ankesa është e pabazuar.

Paneli e vlerësoj lejueshmërinë e ankesës dhe gjenë se e njëjta i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 77 paragraf 5 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe nenin 4 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Pretendimet e palës ankuese se KQZ ne vendimin Nr.01/2348/2025, të datës 06.09.2025, për miratimin e rekomandimit të përbërjes së këshillave të vendvotimeve të rregullta dhe me kusht, nuk ka bërë shpërndarjen e komisionarëve në mënyrë proporcionale në Komunën e Istogut të komisionarëve nga subjekti politik IRDK, dhe se ky vendim është në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli i vlerësoj si të pabazuara për faktin se me dispozita ligjore janë përcaktuar qartë përbërjet dhe funksionet e KVV, ku shprehimisht dispozita e nenit 77 par.3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, parasheh se "*Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuar që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë*", ndërsa paragrafi 4 i këtij neni thekson se "*pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja, ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KVV-ve, të cilët nuk i përmbushin kushtet sipas këtij neni*".

Andaj bazuar në dispozitat e sipërcituara ligjore Paneli, vlerëson se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se, me rastin e marrjes se vendimeve nga KQZ, nuk janë respektuar dispozitat ligjore nga neni 77 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe Rregullorja Zgjedhore Nr.11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve, kjo pasi që subjektit politik i është dhënë përfaqësim nga ana e KQZ-së, në mënyrë proporcionale dhe të barabartë për përfaqësim në KVV dhe se kjo përbërje reflekton praktikën e mirë për menaxhimin

e vendotimeve si dhe e njëjta vlen edhe të ekipet e numërimit në QKN që siguron ndarje të qartë të përgjegjësi, transparencë dhe rrjedhë të qetë të procesit zgjedhor.

Mbi këtë bazë Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të sipërcituara, pasi që subjekti politik, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) është e përfaqësuar në KVV në Istog me 12 KVV të rregullt dhe 2 rezervë, në pajtim me këto dispozita dhe në bazë të Formulës për emërimin e KVV-ve, si dhe duke u bazuar në kriteret Rezultatet e Zgjedhjeve të fundit në nivel komunal. Gjithashtu nuk qëndron edhe pretendimi për ndarje jo të barabartë, kjo pasi që KQZ ka vepruar drejtë lidhur me përfaqësimin e komuniteteve, pasi që përfaqësimi i komunitetit Egjiptian është me gjithsejtë 110 anëtarë në Këshillat e Vendotimeve të rregullta, me kusht si dhe ekipet e numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në disa komuna të Kosovës.

Bazuar në të lartcekurat paneli vlerëson se KQZ ka bërë shpërndarjen e KVV-ve në vendvotimet e rregullta, me kusht në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore ku ndarja është bërë duke trajtuar në mënyrë të barabartë për të gjitha subjektet politike në mënyrë që kjo përfshirje të reflektoj pjesëmarrjen e barabartë për të gjithë ata që marrin pjesë në procesin zgjedhor.

Përfundimisht paneli ka gjetur se KQZ-ja ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjitha subjektet politike, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, si për subjektet që kanë fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet e fundit, e po ashtu edhe për të gjitha subjektet tjera pjesëmarrëse dhe se mbi këtë arsye të njëjtave nuk iu është bërë ndonjë padrejtësi me vendimin Nr.01/2348/2025, të datës 06.09.2025, për Miratimin e Rekomandimit të Përbërjes së Këshillave të Vendotimeve të Rregullta dhe me Kusht, në këtë kontekst duhet pasur parasysh edhe dispozitën ligjore nenin 77 paragrafi 4 të LZP-së e cila i jep të drejtë KQZ-së, për të emëruar anëtarë të KKV sipas zgjedhjes së saj, pa marrë parasysh numrin e votave të fituara në zgjedhjet e fundit.

Prandaj, nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i refuzuar ankesën si të pabazuar.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZLA.nr.33/2025 datë 12.09.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.